



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Datë: 08.08.2023
Ref. KM-273/23

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) neni 15, Shtojca 11 të Rregullores (QRK)-Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30.03.2021), dhe Nenin 20 (paragrafët 1, 4 dhe 5) të Ligjit Nr. 03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, (Gazeta Zyrtare Nr. 44, datë 22.12.2008) si dhe në bazë të rekomandimit të Komisionit për vlerësim dhe autorizim të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, me Ref.04-382/23, të datës 31.07.2023, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

VENDIM

Për futjen në regjistër dhe lejimin e autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve për përdorim

1. Lejohet importimi, vendosja në treg dhe përdorimi i autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve – **Chorus 50 WG** i prodhuesit “**Syngenta Crop Protection AG**”, Zvicër nga përfaqësuesi i saj “**Fitofarma “SH.P.K, Ferizaj**”.

2. **LLOJI I PRODUKTIT:** Fungicid

3. **PËRMBAJTJA E SUBSTANCËS AKTIVE:** Cyprodinil.....500g/kg

4. PËRDORIMI:

Përdoret ne :

Mollë: kundër kromës së mollës (*Venturia inaequalis*) me dozë 30-50g/100 L ujë. Trajtime parambrojtëse nga faza e majës jeshile deri në rrëzimin e petlave, 3-4 trajtime, doza maksimale përdoret në trajtime kurative.

Kalbëzimi i frutave (*Monilinia spp.*) me dozë 100g/100 L ujë, trajtimi bëhet gjatë lulëzimit, 2 trajtime.

Alternaria mali me dozë 100g/100L ujë, trajtimi bëhet pas lulëzimit, 1-2 trajtime.

Dardha: kundër kromës së dardhës (*Venturia pirina*) me dozë 50g/100L ujë. Spërkatja e parë bëhet në fazën e majës jeshile. 3-4 trajtime.

Pemët frutore bërthamore kundër kalbëzimit të frutave (*Monilinia spp.*) 30g/100 L ujë. Gjatë lulëzimit, 2-3 trajtime.

5. SASIA E AMBALAZHIMIT PËR IMPORTIM: 300g, 1kg, 5kg

6. VËREJTJE:

Shumë helmues për organizmat ujore. Mund të shkaktojë efekte të zgjatura negative në mjediset ujore. Mos ndotni ujrat me preparatin ose me ambalazhin e tij.

7. KARENCA:

Molle e dardhe 21 dite, pemë frutore bërthamorë 7 dite.

8. PROPOZIMI I KLASIFIKIMIT:



GHS09 - paralajmërim (cat 1)-i rrezikshëm për ambient

9. VENDI I SHITJËS: Në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

10. Produkti për mbrojtjen e bimëve i autorizuar nga pika 1 e këtij vendimi lejohet të importohet në Republikën e Kosovës, deri në afatin siç është përcaktuar në certifikatën e regjistrimit, duke u bazuar në Databazën e Pesticideve të BE-së/Substancave aktive, ndërsa qarkullimi dhe përdorimi i tij lejohet sipas nenit 26 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve.

11. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Vendimi i dërgohet:

- *Komisioni për vlerësimin dhe autorizimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve;*
- *Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve;*
- *Shërbimi kufitar fitosanitar;*
- *Inspektorët fitosanitar AUV;*
- *Importuesit të produkteve për mbrojtjen e bimëve;*
- *Arkivit.*